



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI I SHQIPËRISË
GRUPI PARLAMENTAR I PARTSË SOCIALISTE



Nr. ____ Prot .

Tiranë, më ____ .2021

Lënda : Depozitim projektligji

Drejtuar:

**Z. GRAMOZ RUÇI
KRYETAR I KUVENDIT TË SHQIPËRISË**

I nderuar Z.Kryetar,

Bazuar në nenin 81 të Kushtetutës së Shqipërisë dhe nenit 68 të Rregullores së Kuvendit. Ju paraqes projektligjin “PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 95/2016 “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E INSTITUCIONEVE PËR TË LUFTUAR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR”.

DEPUTETI PROPOZUES

UKSI MANJA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

PROJEKTLIGJ

Nr. ____ / 2021

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 95/2016 “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E INSTITUCIONEVE PËR TË LUFTUAR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR”,

Në mbështetje të neneve 81, pika 2, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, bëhen këto shtesa e ndryshime:

Neni 1

Në nenin 8, pika 1, togfjalëshi “por nuk mund të tejkalojë kompetencën e përcaktuar nga neni 135, pika 2, të Kushtetutës” shfuqizohet.

Neni 2

Në nenin 21, bëhen shtesat e mëposhtme:

1. Në pikën 3, pas togfjalëshit “Punonjësit e këtij sektori” shtohet togfjalëshi “gëzojnë statusin e oficerit të policisë gjyqësore dhe”.
2. Pas pikës 3, shtohet pika 4 dhe 5, me këtë përmbajtje:
“4. Paga e punonjësve të këtij sektori është e njëjtë me pagën e oficerit nga shërbimet e policisë gjyqësore, sipas përcaktimit të nenit 39/1, të këtij ligji.
5. Punonjësit e këtij sektori përfitojnë të njëjtin trajtim si punonjësit e Byrosë Kombëtare të Hetimit, sipas përcaktimit të nenit 40/1, të këtij ligji.”

Neni 3

Pas nenit 35, shtohet neni 35/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 35/1

Paga e Drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit

1. Paga e Drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit përbëhet nga paga bazë, shtesa për vjetërsi dhe shtesa për vështirësi pune dhe për shkak të heqjes dorë nga privatësia.
2. Paga bazë është e barabartë me pagën bruto fillestare të prokurorit pranë Prokurorisë së Posaçme, sipas legjislacionit në fuqi për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.
3. Shtesa për vjetërsi llogaritet në masën 2 për qind të pagës referuese bazë, sipas përcaktimit të legjislacionit në fuqi për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, për çdo vit shërbimi në funksion, por jo më shumë se 25 vjet shërbim.
4. Shtesë për vështirësi pune dhe për shkak të heqjes dorë nga privatësia llogaritet në masën 70 për qind të pagës bruto fillestare të prokurorit pranë Prokurorisë së Posaçme.”

Neni 4

Pas nenit 36, shtohet neni 36/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 36/1

Paga e zëvendës drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit

1. Paga e zëvendës drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit përbëhet nga paga bazë, shtesa për vjetërsi dhe shtesa për vështirësi pune dhe për shkak të heqjes dorë nga privatësia.
2. Paga bazë është e barabartë me 80 për qind të pagës bruto fillestare të prokurorit pranë Prokurorisë së Posaçme, sipas legjislacionit në fuqi për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.
3. Shtesa për vjetërsi llogaritet në masën 2 për qind të pagës referuese bazë, sipas përcaktimit të legjislacionit në fuqi për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, për çdo vit shërbimi në funksion, por jo më shumë se 25 vjet shërbim.
4. Shtesë për vështirësi pune dhe për shkak të heqjes dorë nga privatësia llogaritet në masën 70 për qind të pagës bruto fillestare të prokurorit pranë Prokurorisë së Posaçme.”

Neni 5

Pas nenit 38, shtohet nenit 38/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 38/1

Paga e hetuesit të Byrosë Kombëtare të Hetimit

1. Paga e hetuesit të Byrosë Kombëtare të Hetimit përbëhet nga paga bazë, shtesa për vjetërsi dhe shtesa për vështirësi pune dhe për shkak të heqjes dorë nga privatësia.
2. Paga bazë është e barabartë me 60 përqind të pagës bruto fillestare të prokurorit pranë Prokurorisë së Posaçme, sipas legjislacionit në fuqi për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.
3. Shtesa për vjetërsi llogaritet në masën 2 për qind të pagës referuese bazë, sipas përcaktimit të legjislacionit në fuqi për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, për çdo vit shërbimi në funksion, por jo më shumë se 25 vjet shërbim.
4. Shtesë për vështirësi pune dhe për shkak të heqjes dorë nga privatësia llogaritet në masën 70 për qind të pagës bruto fillestare të prokurorit pranë Prokurorisë së Posaçme.”

Neni 6

Pas nenit 39, shtohet nenit 39/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 39/1

Paga e oficerit nga shërbimet e policisë gjyqësore

1. Paga e oficerit nga shërbimet e policisë gjyqësore të Byrosë Kombëtare të Hetimit përbëhet nga paga bazë, shtesa për vjetërsi dhe shtesa për vështirësi pune dhe për shkak të heqjes dorë nga privatësia.
2. Paga bazë është e barabartë me 60 përqind të pagës bruto fillestare të prokurorit pranë Prokurorisë së Posaçme, sipas legjislacionit në fuqi për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.
3. Shtesa për vjetërsi llogaritet në masën 2 për qind të pagës referuese bazë, sipas përcaktimit të legjislacionit në fuqi për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, për çdo vit shërbimi në funksion, por jo më shumë se 25 vjet shërbim.
4. Shtesë për vështirësi pune dhe për shkak të heqjes dorë nga privatësia llogaritet në masën 50 për qind të pagës bruto fillestare të prokurorit pranë Prokurorisë së Posaçme.”

Neni 7

Pas nenit 40, shtohet neni 40/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 40/1

Trajtimi i punonjësve të Byrosë Kombëtare të Hetimit

1. Drejtori, zëvendës drejtori, hetuesit e Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe oficerët nga shërbimet e policisë gjyqësore të Byrosë Kombëtare të Hetimit përfitojnë të njëjtin trajtim që përfitojnë punonjësit e policisë së shtetit, sipas legjislacionit në fuqi për policinë e shtetit.

2. Trajtimi i punonjësve, sipas pikës 1, të këtij neni, përfshin të drejtën e pushimit vjetor dhe pushimeve të tjera të pagueshme, lejen pa të drejtë page, trajtimin financiar gjatë qëndrimit në punë, të drejtën për sigurim shëndetësor të veçantë, të drejtën për përfitim të kredisë me interesa të butë, kompensimin për strehim, sigurimin e jetës, mbrojtjen e veçantë, si dhe trajtimin e familjarëve të punonjësve që humbasin jetën për shkak të detyrës.

3. Këshilli i Ministrave miraton rregullat, procedurat dhe kriteret për trajtimin e punonjësve, sipas pikës 1 dhe 2 të këtij neni, me të njëjtin trajtim që përfitojnë punonjësit e policisë së shtetit, sipas legjislacionit në fuqi për policinë e shtetit.”

Neni 8

Në nenin 44, pika 2, pas togfjalëshit “pranë Prokurorisë së Posaçme” shtohet togfjalëshi “dhe punonjësit e administratës së Byrosë Kombëtare të Hetimit”.

Neni 9

Pas nenit 44, shtohet neni 44/1 me këtë përmbajtje

Neni 44/1

Shpërblimi për vështirësi pune dhe për shkak të heqjes dorë nga privatësia

1. Nëpunësi civil gjyqësor në gjykatat e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimin të organizuar përfiton shtesë për vështirësi pune dhe për shkak të heqjes dorë nga privatësia në masën 50 për qind të pagës përkatëse.

2. Nëpunësi civil në prokurorinë e posaçme dhe në Byrosë Kombëtare të Hetimit përfiton shtesë për vështirësi pune dhe për shkak të heqjes dorë nga privatësia në masën 50 për qind të pagës përkatëse. Kanë të drejtë të përfitojë shtesë për vështirësi pune dhe për shkak të heqjes dorë nga privatësia në masën 50 për qind të pagës përkatëse edhe punonjësit e tjerë të Prokurorisë së Posaçme dhe të Byrosë Kombëtare të Hetimit që duhet të plotësojnë kushtet e sigurisë para caktimit në detyrë ose emërimit, sipas nenit 6 të këtij ligji.

Neni 10

Dispozitë kalimtare

Drejtori, zëvendës drejtori, hetuesit e Byrosë Kombëtare të Hetimit, oficerët nga shërbimet e policisë gjyqësore të Byrosë Kombëtare të Hetimit si dhe punonjësit e sektorit të hetimit financiar përfitojnë pagën, sipas përcaktimeve të këtij ligji, nga data e emërimit të tyre në detyrë.

Neni 11

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

GRAMOZ RUÇI